


1. Çfarë nënkujojnë të drejtat e pronësisë intelektuale?

- ✓ Të drejtat e pronësisë intelektuale nënkujojnë përbledhje të kompetencave të caktuara që i gjëzojnë subjektet e këtyre të drejtave mbi objektet e të drejtave të pronësisë intelektuale (siç janë inovacionet, analizat grafike, dizajnimet, emrat gjeografik, veprat autoriale, objektet e të drejtave të ngjashme (fonogramet, videogramet, punimet etj.)) etj.



- ✓ Të drejta të pronësisë intelektuale janë patentet, markat tregtare, dizajnimet industriale, shenjat e prejardhjes, shenjat gjeografike, e drejta autoriale dhe të drejtat e ngjashme (të drejtat e realizuesve, të drejtat e producentëve fonogramik, të drejtat e producentëve të filmave, të drejtat e organizatave RTV etj.).

2. Çfarë nënkujojnë termat mallra pirate dhe mallra të falsifikuara?

- ✓ Termi mallra pirate nënkupton mallra të prodhuara në bazë të veprave autoriale të përvetësuarë në mënyrë kundërligjore ose objekteve të të drejtave të ngjashme. Zakonisht bëhet fjalë për kopje ilegale të të drejtave autoriale (si për shembull, publikimi i ndonjë romani pa leje të autorit ose kopjimi i romanit pa pëlqimin e botuesit),

përkatësisht për objekte të të drejtave të ngjashme (si për shembull, kopjimi i audio-disqeve, audio dhe video-disqeve (filmave) etj.).

- ✓ Termi mallra të falsifikuara i nënkupton mallrat bashkë me ambalazhin, në të cilat pa autorizim është shënuar marka tregtare identike me markën tregtare të regjistruar për këtë lloj malli ose marka tregtare e cila sipas karakteristikave të saj nuk mund të dallohet nga marka tregtare e regjistruar (për shembull, veshjet në të cilat është shënuar marka tregtare pa pëlqimin e subjektit që e gjzon të drejtën e të njëjtës markë tregtare).



- ✓ Në kuptimin më të gjërë të fjalës, termat mallra pirate dhe mallra të falsifikuara nënkujojnë edhe mallra me të cilat shkelen edhe të drejtat e tjera të pronësisë intelektuale, siç janë patentet (për shembull, kur në një mall të caktuar teknik gjendet një patent pa pëlqimin e ideatorit ose kur prodhohet një medikament i patentuar pa pëlqimin e ideatorit të tij).

3. Çfarë mund të ndodh kur klienti do të blej mallra pirate ose të falsifikuara?

- ✓ Në praktikë janë regjistruar rastet në vijim: helmim me pijet alkoolike të falsifikuara, shfaqje

të alergjive nga detergjentet, shampot dhe prodhimet kozmetike të falsifikuara, prani të antibiotikëve dhe analgetikëve në medikamentet për ulje të temperaturës dhe rezistencë ndaj antibiotikëve; shitje të pjesëve jokualitative në industrinë automobilistike, që rezultojnë me komunikacion të pasigurt dhe me aksidente rrugore; shitje të mallrave tekniqe pa garanci, të cilat mund ta prishin instalimin dhe të shkaktojnë zjarr; me softuer pirat të modifikuar mund të dëmtohet kompjuteri; kualitet i dobët i librave, filmave, muzikës pirate etj.

- ✓ Blerja e mallrave pirate dhe të falsifikuara mund të rezultojë me: ndihmë të krimit të organizuar sepse shumë shpesh falsifikimet dhe pirateria janë pjesë e aktiviteteve kriminale, anashkalohet pagimi i tatimeve dhe dëmtohet buxheti shtetëror; mbyllen kinematë; dëmtohet stimulimi i krijimtarisë dhe kulturës së një vendi etj.

4. Si të detektohet malli i falsifikuar dhe pirat?

- ✓ Duke mos blerë: mallra nga shitësit e rrugëve, të cilët zakonisht nuk janin kupon tatimor; medikamente dhe pajisje mjekësore nga tregjet e gjelbra; produkte pa deklaracion në gjuhën maqedonase; inçizime pa leje dhe instalim të softuerëve pa licencë; mallra me ambalazh jostandard etj.



5. *Ku duhet të drejtohen klientët kur do të shikojnë në treg mallra pirate dhe të falsifikuara?*

- ✓ Kontrolllet lidhur me shkeljen e të drejtave të pronësisë intelektuale bëhen nga ana e Inspektoratit shtetëror të tregut.



6. *A mund të jetë përgjegjës klienti për blerjen e mallrave pirate dhe të falsifikuara?*

- ✓ Sipas legjislacionit vendas, për shkeljen e të drejtave të pronësisë intelektuale mund të përgjigjet vetëm tregtar, por jo edhe klienti. Kur bëhet fjalë për përgjegjësinë penale, klienti parimisht nuk mund të përgjigjet, por nëse ai i lëshon në qarkullim mallrat e blera pirate ose të shkarkuara nga Interneti, për të cilat vlefjnë të drejtat autoriale ose të drejtat e ngjashme, qoftë edhe pa fitim, ai mund të mbaj përgjegjësi penale.



ORGANIZATA E KONSUMATORËVE TË MAQEDONISË
rr. "Vodnjanska" p.n. 1000 Shkup;
tel./faks: 3179-592; tel. 3212-440;
url: www.opm.org.mk; e-mail: opm@opm.org.mk

Organizata e konsumatorëve-Manastir
rr. Braqa Mingovi nr.5
7000 Manastir
tel/faks: 047 / 228 246

Organizata e konsumatorëve-Shtip
rr. Vasil Glavinov pn.
2000 Shtip
032 / 529-745, celular 075 / 306 605

Organizata e konsumatorëve-Ohër
"Qendra Tregtare – Amam, nr. 218/1, katë II,
6000 Ohër
tel/faks: 046 / 523 348

Organizata e konsumatorëve-Koçan
rr. Rade Kratovçe nr.1
2300 Koçan
tel/faks: 033 / 274 013, lokali 104


Organizata e konsumatorëve-Tetovë
rr. JNA, Komuna e Tetovës
1200 Tetovë
tel/faks: 044 / 356 630



ОРГАНИЗАЦИЈА НА ПОТРОШУВАЧИТЕ
НА МАКЕДОНИЈА



РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
МИНИСТЕРСТВО ЗА ЕКОНОМИЈА



**Mallrat pirate dhe të falsifikuara:
rrezik për shëndetin, sigurinë dhe
për pronën e klientëve!**